



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2536/4 Prot.

Tiranë, më 22.10.2025

VENDIM

Nr. 55 Datë 22.10 2025

**“PËR
NJË NDRYSHIM NË STRUKTURËN ORGANIZATIVE TË INSTITUTIT TË
KËRKIMIT SHKENCOR TË SPORTIT”**

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë, në Statutin e UST-së neni 43, në VKM me nr. 243, datë 20.04.2023 "Për një ndryshim në VKM nr.748, datë 11.06.2009 të Këshillit të Ministrave "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë", të ndryshuar, në VKM nr.329, datë 12.04.2017 "Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik", të ndryshuar, në Udhëzimin e MASR nr.29, datë 10.09.2018 "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në institucionet publike të Arsimit të Lartë, në Vendimin e Senatit Akademik me nr.13, datë 28.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimin e pagës për vitin 2025", në Vendimin e Bordit të Administrimit nr.08, datë 29.01.2025 "Për miratimin e strukturës organizative dhe analitike dhe klasifikimin e pagës për vitin 2025", në Vendimin e Rektorit të UST-së, me nr. 244, datë 13.10.2025 "Për emërimin e Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes Prof. Asc.Dr. Enkeleida Lleshi", në Vendimin e Dekanit të FSHL, me nr. 20, datë 13.10.2025 "Për emërimin e Zv/Dekanit në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes" si dhe në shkresën e Drejtorit të IKSHS me nr. 2506 prot., datë 16.10.2025 "Propozim për emërim të përkohëshëm të Përgjegjësit të Njesisë Bazë "Departamenti i Performancës Sportive", Vendimin e Rektoratit nr 125 datë 17.10.2025 , në Vendimin e Senatit Akademik nr 136, datë 20.10.2025, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 22.10.2025,

V E N D O S I :

1. Të miratojë ndryshimin e strukturës pranë Departamentit të Performancës Sportive në Institutin e Kërkimit Shkencor të Sportit, në Universitetin e Sporteve të Tiranës si mëposhtë:
 - Sipas strukturës ishte: Personel akademik, 1(një) Profesor i Asociuar
 - Bëhet: Personel akademik, 1(një) Lektor

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi, IKSHS, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkiv/Protokollit, si dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

